



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 30.9.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BASHKIMI EVROPIAN-SHQIPËRI, PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME CILËSINË E VËZHGUESES, NË PUNËN E AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE DHE MËNYRËN E KËSAJ PJESËMARRJEJE NË KUADRIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT (KE) NR.168/2007

- HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 30 shtator 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e Rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007”.

Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten, znj.Vasilika Hysi. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm Ministria e Drejtësisë, znj.Etilda Gjonaj dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenet 12 dhe 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektiligji mundëson ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian-Shqipëri, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë, me cilësinë e vëzhgueses, në punën e Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore dhe mënyrën e kësaj pjesëmarrjeje në kuadrin e rregullores së Këshillit (KE) nr.168/2007.

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore është krijuar nga rregullorja e Këshillit (EC) nr.168/2007 dhe ka si objektiv dhënien e asistencës dhe të ekspertizës lidhur me të drejtat themelore tek organet, zyrat dhe agjencitë e komunitetit dhe të shteteve anëtare, gjatë zbatimit të së drejtës komunitare, si dhe gjatë marrjes së masave ose përcaktimit të veprimeve brenda kompetencave të tyre, për të respektuar plotësisht të drejtat themelore.

Kjo marrëveshje është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.785, datë 26.12.2018, bazuar në iniciativën e ndërmarrë në vitin 2013, nëpërmjet letrës së ministrit për Punët e Jashtme, drejtuar Komisionit Evropian mes të cilës ka shprehur interesin për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë me statusin e vëzhguesit tek Agjencia, e cila është e hapur për pjesëmarrjen e vendeve kandidate si vëzhguese.

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) është qendra e BE-së e ekspertizës për të drejtat themelore, një nga agjencitë e decentralizuara të BE-së. Këto agjenci janë krijuar për të ofruar këshilla ekspertësh pranë institucioneve të BE-së dhe Shteteve Anëtare për një varg çështjesh. Agjencia ndihmon për të siguruar që të drejtat themelore të njerëzve që jetojnë në BE mbrohen.

Agjencia synon të krijojë një kulturë të të drejtave themelore në të gjithë BE-në mes mbledhjes së informacioneve, shkëmbimit të njohurive dhe këshillave, promovimit të të drejtave themelore, angazhimit të ekspertëve. Fushat ku vepron FRA janë të shumta si: qasja në drejtësi, azili, migracioni dhe kufijtë, shoqëria e informacionit, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave, gjinia, krimet e urrejtjes, LGBTI, personat me aftësi të kufizuara, racizmi dhe intoleranca, të drejtat e fëmijës, Romët.

Pas shprehjes së dakordësisë nga shteti shqiptar për anëtarësimin e Shqipërisë me statusin e vëzhguesit në Agjencinë për të Drejtat Themelore, Këshilli i Stabilizimi Asociimit ka miratuar aplikimin e vendit tonë, pasi janë mbyllur me sukses procedurat e mbikëqyrjes parlamentare, në bazë të nenit 352, të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Sipas projektiligjit, krahas ratifikimit të Marrëveshjes, ngarkohet Ministria e Drejtësisë të emërojë përfaqësuesin e Republikës së Shqipërisë në Bordin drejtues të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

Bazuar në mendimet e sjellja e Komisionet e përhershme që shqyrtuan projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi dhe diskutimet e anëtarëve të Komisionit të Ligjeve, në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

RELATORE

Vasilika HYSI

KRYETARI

Ulsi MANJA